PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATE 26.12.2025

Sot ne sallen e mbledhjeve te K. B. Devoll zhvillohet mbledhja e radhes sipas njoftimit te dates 22.12.2025. Te pranishem ne salle:

Alfredi Gjata ,Valbona Spaho,Imelda Cucka,Eroldi Begolli, Oljana Comka, Festim Kaso, Oliver Mulla

Lindita Cokani, Vladimir Kello , Vladimir Gjyli, Albana Skoti , Giela Hoxhalli.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 1, miratimin e rendit te dites. Hapet votimi: 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me miratimin e procesverbalit te dates 25.11.2025 dhe 10.12.2025. Hapet votimi per te dyja. Hapet votimi: 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Projekt-Vendim Nr.76 Date 18.12.2025 "Miratimin e perfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredise

per strehim."

Eduard Duro: Keto jane dy kuotat e fundit per kete vit, ti ezaurojme qe te vazhdojme me kuotat e tjera ne vazhdimesi.

*Komisioni eshte mbledhur dhe nuk ka asnje kundershtim me kete projekt-vendim.

Alfredi Gjata: Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 4, Projekt-Vendim Nr.77 Date 18.12.2025 " Për kuotat financiare te ushqimit ne mensa e konvikte dhe percaktimin e kritereve per perfitimin e bursave e te pagesave per nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore

publike."

Festim Kaso: Me sa shikoj te gjithe emrat ketu jane banore ne qytet dhe nuk rrine ne konvikt.

Eliverta Pavliqoti: Kete vit kane ardhur shume pak kuota.

Festim Kaso: Ne si rreth kemi nxenes qe vazhdojne shkollat profesionale ne Korce ose rrethe te tjera?

Eliverta Pavliqoti: Keto jane te arsimit 9-vjecar Perzgjedhja e ketyre behet ne baze te kerkeses qe bejme ne Ministri, dhe ne shikojme ngjashmerine e kritereve. Meqenese kuota eshte shume e ulet ne menduam ta bejme kriterin me te forte qe te perfitojne ata qe jane me shume ne nevoje.

Vladimir Kello: Femijet rome jo vetem qe nuk shkojne ne shkolle, por prinderit e tyre bejne shkelje qe i nxjerrin per te lypur. Duhet te vijen para pergjegjesise ligjore ata prinder qe bejne nje shkelje te tille. Femijet e tjere nuk marrin asnje ndihme per te shkuar ne shkolle, nderkohe qe ketyre femijeve u jepet ndihme monetare, asistence dhe nuk shkojnene shkolle por lypin.

Imelda Cucka: Per sa i perket vijieshmerise se nxenesve te asaj kategorie, te gjithe drejtuesit qe kane nxenesit e tyre ne insitucionet e tyre arsimore ne fund te cdo muaji sjellin nje listeprezence ku firmos mesuesi dhe drejtori i shkolles. Rrezik braktisjeje ka, por rrezik braktisjeje ka.

Vladimir Kello: Duhet te ndergjegjesohen qe te arsimohen.

Eliverta Pavliqoti: Ne momentin qe ne bejme planifikimin e ketyre bursave, elementi i pare qe shqyrtohet ne dosje eshte frekuentimi.

Zerina Sinani: Ne keto raste i lutem keshilltareve dhe cdokujt tjeter te na i referoni.

Alfredi Gjata: Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 5. Projekt-Vendim Nr.78 Datë 18.12.2025 "Për nje ndryshim me vendimin Nr. 82 date 25.11.2025 "Per miratimin e linjave per transportin e punonjesve arsimore qe punojne dhe te
nxenesve që mësojne jashte vendbanimit."

Eduard Duro: Linja Nikolice-Arrze eshte shtuar sepse eshte ai femija qe do te trajtohet me ndihme. Femija eshte ne Nikolice dhe shkollen e ben Arrze.

Vladimir Kello: Une per kete familje krenohem.

Alfredi Gjata: Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 6. Projekt-Vendim Nr.79 Date 19.12.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar të nënpunesve civile dhe të punonjesve administrative të Bashkisë Devoll për vitin 2026."

Adriana Rushitaj: Kemi 2 projekt-vendime te paraqitura per keto problematika , te cilat kerkojne riorganizimin e struktures dhe caktimin e nivelit te pagave te Bashkise dhe Agjencise te sherbimeve publike.

*Sqaron me detaje sipas relacionit shpjegues ne lidhje me cdo ndryshim te struktures.

Drejtoria Arsimit dhe Kultures do ta ndahet ne 2 drejtori: Drejtoria e Arsimit Rinise dhe Sporteve dhe Drejtoria e Kultures, Trashegimise Kulturore dhe Turizmit. Ne lidhje me pagat nuk ka pasur rritje.

Eduard Duro: Paga minimale 50’000 do te shtohet ne Janar kur te behen ndryshimet, pasi nuk ka dale ende VKM.

Alfredi Gjata: Hapim votimin per projekt-vendimin 79 dhe Projekt-Vendim Nr.80 Datë 19.12.2025 "Për rishikimin dhe miratimin e strukturës, organikes dhe nivelit të pagave te agjencisë së sherbimeve publike në varësi të Bashkisë Devoll per vitin 2026”, meqenese u diskutuan te 2 njekohesisht.

12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 8, Projekt-Vendim Nr.81 Datë 19.12.2025 "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% per bllok-ndihmën ekonomike dhe fondet e buxhetit vendor për muajin Nentor 2025."

Nuk ka diskutime.

Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 9, Projekt-Vendim Nr.82 Datë 19.12.2025 "Për nisjen e procedures per rishikimin e pjesshem te pershpejtuar te planit te pergjithshem vendor te Bashkise Devoll.”

Tatiana Spaho: Plani i pergjithshem vendor i Bashkise Devoll ndahet ne 5 sisteme. Ne sistemin urban perfshin te gjitha zonat e urbanizuara brenda qytetit dhe brenda fshatit dhe ka nje vije kufizuese qe quhet vija e gjelber qe quhej vija e verdhe me perpara. Mbushje urbane do te thote qe ne brenda zonave urbane ne vend bosh bejme ndertime te reja duke shfrytezuar dhe infrastrukturen ekzistuese. Ndersa konsolidim urban do te thote qe zona eshte disi e urbanizuar po jo e konsoliduar plotesisht me infrastrukture. Nje nga kushtet kryesore eshte largesia. Nese ndertojme nje shtepi nje kateshe, largesia nga kufiri eshte 4+1 qe do te thote eshte 2. Nderda ne zonen me konsolidim urban, pavarsisht numrit te kateve largesia e objektit nga kufiri eshte 5m dheobjekti ekzistues duhet te jete 2.

Alfredi Gjata: Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 10, Projekt-Vendim Nr.83 Date 19.12.2025 "Per ngritjen e komisionit te apelimit administrativ te taksave dhe tarifave vendore prane Bashkise Devoll dhe miratimin e regullores se funksionimit dhe organizimit te ketij komisioni."

Nuk ka diskutime

Alfredi Gjata: Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 11, Projekt-Vendim Nr.84 Date 22.12.2025 "Per miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Devoll."

Festim Kaso: Pjesen e investimeve per vitin 2026 e shoh shume te vaket.

Eduard Duro: Ka dhe investime te tjera, sic eshte rikonstruksioni i godines se zjarrfikeses, por per asfaltimin e rrugeve nuk kemi mbaruar akoma preventivat e rrugeve qe kemi projektuar dhe sapo te kalojme do te kalojne ne buxhetin e vitit 2026. Do te jene loti 4 i nderhyrjeve ne rruget e Bilishtit dhe 12 rruge dytesore te fshaterave te Devollit.

Vladimir Kello: Kryetar, jane mbajtur parasysh objektet e zonave prioritare ne projekt-buxhetin e 2026-es?

Eduard Duro: Po patjeter.

Festim Kaso: Persa i perket mbremjes se matures, shikoj ketu keto 10 milion leke qe jepen kengetareve, nderkohe qe te rinjte hane dhe pine me leket e tyre ne lokal me vone, pse mos te i vestohen keto leke ne promovimin e vendit e kultures se tij.

Aurela Furxhi: Ato duan te rinjte, nderkohe keto qe po thoni ju ne i kemi te parashikuara.

Oljana Comka: Tek pjesa e rrugeve qe diskutuam do tedoja te merrnit parasysh disa rrugica ne fshatin Baban, qe jane me balte dhe nuk i gjen ne asnje fshat tjeter. Te pakten nje makine me cakull. Gjithashtu edhe rruga e Hocishtit.

Eduard Duro: Planifikimi eshte bere ne varesi te kerkesave te administratoreve.

Oljana Comka: Ne lidhje me nje kerkese qe kam bere me perpara per vijezimin e rruges Hocisht-Bilisht. Ju bej me dije qe ajo rruge eshte mbi 5m, pasi une e mata vete dhe kete gje mund ta vertetoni kollaj.

Eduard Duro: Ok, ajo do te vijezohet ne mes.

Alfredi Gjata: Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 12, Projekt-Vendim Nr.85 Date 22.12.2025 "Dhënien e Titullit Qytetar Nderi për Z.Ridvan Vait Bode."

Ky projekt vendim do te shtyhet per muajin e ardhshem pasi mungon nje dokument.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 13, Projekt-Vendim Nr.86 Datë 22.12.2025 "Për miratimin e memorandiumit të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit dhe statutit."

Eduard Duro: Ky eshte nje memorandium qe ne kemi nenshkruar me 4 bashki te tjera, qe ne kuadrin e aplikimeve te projekteve nga BE, te aplikojme si grup i perbashket.

Alfredi Gjata: Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 14, Projekt-Vendim Nr.87 Datë 22.12.2025 "Për miratimin e kalendarit te pergatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029"

Nuk ka diskutime.

Hapet vendimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me nje projekt-vendim, i cili ka ardhur jashte radhe, Projekt-Vendim nr. 88 Date 24.12.2025 "Perdorimin e fondit transfertes se pakushtezuar per pagesen e detyrimeve te prapambetura."

Nuk ka diskutime

Alfredi Gjata: Hapet votimi 12 pro, 0 kunder, 0 abstenim.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Kostandine Brotholli

Alfredi Gjata

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL